15029

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 15029

VENDIM
PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 30.06.1996 une gjyqtarje e Gjykates se Rrethit Tirane, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Tom Doshi dhe Tonin Shpati, te cilet kerkojne regjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALDOSCH" Sh.p.k. dhe :

KONSTATOVA:

Kerkuesit kerkon regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALDOSCH" sh.p.k. me seli Shkoder, rruga Kongresi I Lushnjes nr.77,me ortak Tom Doshi dhe Tonin Shpati, me administratore Tom Doshi, me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit si shtepia banimi, dyqane, magazina, reparte prodhimi etj. si dhe do te prodhoje me mjetet e saja materiale ndertimit per nevojat e vete shoqerise ashtu edhe per tregtim, katieret e prodhimit te materialeve te ndertimit do t'i hape fillimisht ne Bushat te rrethit te Shkodres dhe ne Vrake te rrethit Malesi e Madhe.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 10.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe nenit 33 te ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

VENDOSA:

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALDOSCH" sh.p.k. me seli Shkoder, rruga Kongresi I Lushnjes nr.77,me ortak Tom Doshi dhe Tonin Shpati, me administratore Tom Doshi, me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit si shtepia banimi, dyqane, magazina, reparte prodhimi etj. si dhe do te prodhoje me mjetet e saja materiale ndertimit per nevojat e vete shoqerise ashtu edhe per tregtim, katieret e prodhimit te materialeve te ndertimit do t'i hape fillimisht ne Bushat te rrethit te Shkodres dhe ne Vrake te rrethit Malesi e Madhe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE
FLORINA TEGU

Republika e Shqiperise
Gjykata e rrethit Tirane
Nr. rreg

## VENDIM

## ~~MEX~~ GJYQTARIT TE VETEM

Sot, më 19.1. 1998 ( nentedhjete e te e )ne zyrene gjykates se rrethit Tirane , u paraqit para meje gjyqtares Merita Bikaj , shpk"ALDOSCH " me objekt depozitmin e dokumenteve ;pasi i mora ne shqyrtim :

## KONSTATOVA

Se, kerkuesi shp k"ALDOSCH " eshte rregjistruar si person juridik me vendimin me nr.15029 date 30.06.1996 te gjykates se rrethit Tirane me objekt ushtrim veprimtarie ne fushen e ndertimit

Me vendimin e asamblese se ortakeve me nr. dt.12.01.1998, eshte vendosur shtimi i objektit te aktivitetit duke ushtruar ate dhe ne fushen eeksport-import, më shumice e pakice , artikujve te ndryshem ushqimore te gateshme ,drithra , pija alkolike , auto mjete e pjese kembimi , kozmetike .

Nga dokumnetet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe duhet te pranohet .

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992 dhe ligjit 7667 dt. 28.1.1993

## V4NDOSA

Pranimin e kerkeses . Urdherimin e zyres se rregjistrit te deopzitohet vendimi i asamblese se ortakeve per shtim objekti aktivitetit .

Urdherimij e zyres se rregjistrit te beje shenimet me viz te kuqe ne kollonat 4,5,9c

Tirane, me 19.1. ,1998

GJYQTARE

Merita Bikaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA RRETHIT TIRANE
Nr.15029/1 regj. treg.
/2

Tirane me 28.04. 1999

6499

VENDIM
( i gjyqtarit te vetem)

Sot me daten 28.04.1999 ne gjykaten e rrethit Tirane une ________ ________ gjyqtare prane kesaje gjykate mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit te Sh.P.K."Aldosch" me seli ne Shkoder Z. Tom Doshi me objekt depoozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te kesaje shoqerie me Nr date 25.04.1999 dhe

konstatova

Se Sh.P.K. "Aldosch" me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati eshte rregjistruar si person juridik me vendimin e kesaje gjykate Nr. 15029 dt.30.06.1996 me objekt aktiviteti fushen e ndertimit .

Me daten 12.01.1998 eshte depozituar gjithashtu edhe nje vendim i asamblese se ortakeve per shtese te aktivitetit tregetar.

Gjithashtu, sic rezulton nga dokumentet e paraqitura me vendimin Nr. date 25.04.1999 asambleja e ortakeve te kesaje shoqerie ka vendosur te shtoje perseri aktivitetin e saje ne fushat e tregetimit (eksport import) te karburanteve e vajerave lubrifikante si dhe te prodhimit e tregetimit te artikujve duhan cigare. Nga dokumentet e paraqitura rezulton se Sh.P.K."Aldosch" eshte e rregjistruar ne zyren e tatim taksave Shkoder me Nr.kodi fiskal 3.353.033 duke vazhduar aktivitetin e saje edhe per periudhen 01.01.1999 deri me 31.12.1999.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte e duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638 dt.19.01.1992 dhe Nr.7667 dt.28.01.1993

VENDOSA

Pranimin e kerkeses, urdherimin e zyres se rregjistrit tregetar te depozitoje vendimin e asamblese se ortakeve te Sh.P.K."Aldosch" Nr. 1 date 25.04.1999 per shtimin e aktivitetit te kesaje shoqerie duke bere shenimet perkatese ne rregjistrin tregetar ne fleten duke hequr vije te kuqe› ____________.

Tirane me 28.04. 1999

GJYQTARE

/ ________ /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA SHKALLES SE PARE
TIRANE
Nr. Vendimit.15029/3

# VENDIM

(i gjyqtarit te vetem)

Sot me daten 26.01. 2000, ne gjykaten e rrethit Tirane une Gjulia Cop gjyqtare prane kesaje gjykate mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit te Sh.P.K. Alodsch , Z.Tom Doshi me objekt shtimin e aktivitetit tregtar ne fushen e shtypshkrimeve nepermjet montimit e venies ne funksionim te nje sshtypshkronje

## *KONSTATOJ:*

Se SH.P.K. "ALDOSCH" me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati eshte rregjistruar si person juridik me venbdim te kesaje gjykate Nr.15029 dt.30.06.1996 me objekt fushen e ndertimit .
te tregetimit me shumice e pakice te artikujve industrial e ushqimor, karburanteve e vajerave lubbrifikante.

Gjithashtu rezulton nga dokumentet e paraqitura se me vendimin Nr.1 date24.01.2000 asambleja e ortakeve te kesaje shoqerie ka vendosur te shtoje perseri aktivitetin e saje ne fushen e shtypjes se shkrimeve e botimeve te ndryshme nepermjet montimit e venies ne funksionim te nje shtypshkronje.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte e duhet pranuar.

## PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638 dt.19.01.1992 dhe Nr.7667 dt.28.01.1993

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses, shtimin e aktivitetit te shoqerise Aldosch edhe ne fushen e shtypshkrimeve nepermjet montimit e venies ne funksionim te nje shtypshkronje ne qytetin e Tiranes.duke bere shenimet perkatese ne fleten e rregjistrit tregetar me vije te kuqe.

GJYQTARE
Gjulia Cop

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**
**Nr. 15029/3 i Vendimit**

# VENDIM

## I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 04.02. 2004, unë Dhuila Cofo, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit, Z. Tom Doshi, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë të Ortakëve, datë 19.01.2004,

## KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 15029, datë 30.06.1996 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuesi, Z. Tom Doshi, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k. kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 19.01.2004, me anën e të cilit është vendosur për shitjen e masës prej 50% të kuotave të shoqërisë.

Shitësi, ortaku Tonin Shpati do të shesë 50% të kuotave që ai zotëron në shoqëri, në favor të blerësit, ortakut tjetër të shoqërisë Z. Tom Doshi. Blerësi do të bëhet pronar mbi 50% të kuotave që shiten me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky operacion dhe fiton njëkohësisht cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë. Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të datës 19.01.2004, ortakët kanë shprehur vullnetin e tyre për realizimin e shitjes së kuotave.

Po kështu, konform Kreun IV, neni 45,të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" është përpiluar para noterit Agim Robo, kontrata e shit – blerjes së kuotave e datës 24.01.2004 me nr. 424 Rep dhe nr. 46 Kol.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "ALDOSCH" sh.p.k., datë 19.01.2004, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

## V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Ortakëve, datë 19.01.2004, për shitjen e kuotave të shoqërisë.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të pasqyrojë ndryshimet e mësipërme në kollonat përkatëse.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Drita Cafo

15029

Urdher, Ekspromo

Nr. / /

2(a) Aldo K Shkalla

(b) Shoqeri "Voice kopje", me "Kopje te reja" Nr. 22

(c) prodhime, eksport, import

(d) 100000 leke 50% 50%

3 Adm. Tom Doshi, dt. 1966, lindur ne Tirane

6 Statuti i/Akt. dt 27.05.1996 ...

5 Dt 30.05.1996

Statuti nr + Akte

Gjykatesi

[signature]

# KONTRATE THEMELIMI

Sot me daten 27.05.1996

1) Tom Gjek Doshi i dt, lindjes 1966, lindur ne Trush dhe banues ne Shkoder Lagje "Ndoc Mazi Rruga Kongresi Lushnjes Nr.77

2) Tonin Gjon Shpati, lindur dhe banues ne Shkoder Lagje Ndoc Mazi Rruga Kongresi Lushnjes Nr.67

me cilesine e ortakeve te shoqerise tregtare:

NENI 1

Themelojne shoqerime tregetare te emertuar ALDOSCH sh.p.k me seli ne Shkoder.

NENI 2

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1oo.ooo leke i formuar ne keto kuota:

Tom Gjek Doshi 50.000 leke
Tonin Gjon Shpati 50.000 leke.

Ne keto proporcione do te ndahen edhe fitimet e do te perballohen humbjet nga veprimtaria e shoqerise.

NENI 3

Afati i ushtrimit te veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vj

Neni 4

Administrator i shoqerise eshte Tom Doshi

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e ndertimit d

prodhimit te materjaleve per ndertim e te tregetimit te t

NENI 6

Sejcili ortak, para se te heqe dore nga shoqeria, eshte i dety njoftoje me pare ortaket e tjere sipas afateve ligjore.

# S T A T U T

## I SHOQERISE TREGETARE "KENEDI" Sh.P.K.

### "T H E M E L I M I"

Neni 1.

Themelimi i shoqerise tregetare me emertimin ALDOSCH sh.p.k. me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati.

Neni 2.

Selia e shoqerise eshte ne Shkoder ne adresen Lagje Ndoc Mazi Rruga Kongresi Lushnjes Nr.77

### "KOHEZGJATJA"

Neni 3.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saje me nje afat mbi 10 vjete.

### "O B J E K T I"

NENI 4.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e vet ne fushen ndertimore si shtpia banimi, dyqane, magazina, reparte prodhimi etj si dhe do te prodhoje me mjetet e saja materjale ndertimi per nevojat e vete shoqerise ashtu edh per tregetim. Kantjeret e prodhimit te materjaleve ndertimi do ti hape fillimisht ne Bushat te rrethit Shkoder dhe ne Vrake te rrethit Malesi e Madhe.

### " K A P I T A L I "

Neni 5.

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke i formuar nga keto ku

REPUBLIKA E SHQIPERISE



1) Tom Doshi 50.000 leke

2) Tonin Shpati 50.000 leke

Ne kete mase do te jete edhe ndarja e fitimit apo humbjeve qe munde te kete shoqeria.

Neni 6-

Kapitali munde te shtohet me vendim te asamblese se ortakeve. Perqindja e kapitalit te investuar nga sejcili ortak do te percaktoje edhe perqindjen e fitimit apo te humbjeve.

Neni 7.

Shoqeria munde te ndryshoje emertimin, seline . objektin, munde te shtojne numurin e ortakeve me vendim te asamblese se ortakeve.

" DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE "

Neni 8

Organi vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve. Ajo ka te dre te beje ndryshimet ne statut, ne shtimin e kapitalit, te prishe para afatit shoqerine. Vendimet e asamblese se ortakeve perpilohen me shkrim dhe duhet te nenshkruhen nga ortaket.

Neni 9.

Vendimet e marra ne asamblene e ortakeve jane te detyrueshme per zba tim nga te punesuarit ne kete shoqeri

Neni 10.

Veprimtaria teknike e shoqerise do te drejtohet nga ingjinjer nderti te paisur me licence qe do te punesohen nga shoqeria me kontrate te rregullt. Ai do te jete njekohesisht edhe Drejtori teknik i shoq

Neni 11.

Ortaket kane keto te drejta:

-Marrin pjese ne rezultatet e shoqerise sipas kontributit te kapitalit te derdhur.

- Shprehin propozime dhe mendime ne asamblene e ortakeve .

- Njihen me te gjitha te dhenat ekonomiko financjare qe ka shoqeria si dhe me dokumentacionin ekonomiko financjar perkates.

Neni 12.

Ortaket kane keto detyrime:

- Depozitojne kueten e themelimit te kapitalit tee shoqerise.

- Te aktivizohen per te dhene te dhena te domosdoshme ekonomike e financjare qe kane te bejne me mbarvajtjen e shoqerise.

Te kryejn detyrat e ngarkuara nga asambleja e ortakeve.

Ortaket munde te perfaqesohen ne shoqeri me perfaqesues te tyre te caktuar me prokure te posacme per kete qellim.

Neni 13.

Sejcili ortak ka te drejten e heqies dore nga shoqeria ne cdo kohe duke njoftuar ne afatet e percaktuara nga ligji. Ndarja e kapitaleve me rastin e largimit nga shoqeria behet me mirkuptim pas pasqyrimit te nje bilanci ekonomiko financjar per gjith kohen qe ortaku ka qene pjestar i shoqerise. Ne se nuk arrihet zgjihje me mirkuptim konflikti zgjidhet ne rruge gjyqesore.

Neni 14.

Administrator dhe President i shoqerise eshte Tom Doshi

Drejtore teknike eshte ingj. Mimoza Alibali sipas kontrates se punes.

"KOPTTENCAT E ADMINISTRATORIT (PRESIDENTIT)
TE SHOQERISE.

Neni 15.

Administratori (Presidenti) i shoqerise ka keto kopetencat

- Kryen veprime juridike ne emer e per llogari te shoqerise
- Organizon se paku nje here ne muaj mbledhjen e ortakeve.

- Raporton para asamblese se ortakeve me te gjithe aktivitetin ekonomik e financjar te shoqerise.

- I propozon mbledhjes se ortakeve pagat e administrates se shoqerise si dhe te fuqise puntore.

- Propozon ne asamblene e ortakeve marrjen ne pune te personelit ingjinjero teknik dhe mbas miratimit nga asambleja autorizohet te nenshkrua kontratat e punes me to.

-Merr masa disiplinore ndaj personelit te punesuar duke zbatuar dispozitat e Kodit te Punes.

KOPETENCAT E DREJTORIT TEKNIK TE SHOQERISE

Neni 16.

Drejtori teknik drejton dhe organizon punen ne perputhje me projektet e ndertimit apo te prodhimit duke zbatuar me rigorozitet kushtet teknil

- Ai pergjigjet per masat e sigurimit teknik per mbrojtjen ne pune ne baze te rregulloreve perkatese.

- Perpilon dokumentacionin perkates per zhvillimin e punimeve te ndertimit ose prodhimit.

- Jep mendime dhe propozime teknike ne mbledhjen e ortakeve.

DREJTIMI I MARDHENIEVE EKONOMIKE FINANCJARE

Neni 17

Per dokumentimin e veprimtarise ekonomike financjare, hartimin e bilanceve etj, ngarkohet nje ekspert kontabel i cili do te punesohet me kontrate pune te rregullt.

Neni 18

Shoqeria munde te cele llogari te saje ne leke ose valute te huaj brenda ose jashte Shqiperise.

[stamp]



Neni 19.

Shoqeria ka te drejten e tjetersimit, perdorimit e disponimit te pasurive te veta ne perputhje me qellimet e shoqerise.

"MARDHENIET E PUNES "

Neni 20

Mardheniet e punes me personat e punesuar do te rregullohen ne perputhje me dispozitat e Kodit te Punes dhe akteve te tjera nenligjore duke percaktuar ne menyre te hollesishme te drejtat dhe detyrimet e paleve ne kontratat e punes.

Neni 21.

Ortaket munde te ngarkohen per te kryer pune te caktuara duke percaktuar edhe shperblimin perkates i cili nuk perfshihet ne masen e fitimit. Puna qe munde te kryej ndonjeri prej ortakeve si dhe paga qe do te marre vendoset ne mbledhjen e pergjitheshme te ortakeve.

Neni 22.

Ne kete shoqeri munde te punesohen persona fizik vendas ose te huaj si fuqi puntore ashtu edhe specialiste te fushave te ndryshme. Numuri i fuqise puntore dhe i specialisteve do te percaktohet me vendim te mbledhjes se pergjitheshme te ortakeve.

Neni 23.

Mosmarrveshjet midis punedhenesve e punmarresve, kur nuk zgjidhen me pajtim, do te zgjidhen ne rruge gjyqesore.

"BILANCI DHE TE ARDHURAT"

Neni 24.

Shoqeria vepron me dokumentacion te rregullt financjar te perpiluar e mbajtur nga persona te afte e specialist kontabel.

Neni 25.

Ne fund te cdo viti kalendarik perpilohet bilanci vjetor ku pasqyrohen

e dhenat ekonomiko financjare te shoqerise.

Neni 26.

Veprimtaria financjare e shoqerise fillon ne diten e rregjistrimit te saje per vitin e pare, me daten 1 janar per vitet e tjera dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 27.

Bilanci perpilohet nga eksperte kontabel dhe miratohet nga asambleja e ortakeve. Fondet e akumulimit te shoqerise vendosen nga sambleja e ortakeve Fitimet munde te transferohen lirisht edhe jashte shtetit.

"SHPERNDARJA E SHOQERISE"

Neni 28.

Me pelqimin e ortakeve, shoqeria munde te shperndahet ne cdo kohe dhe per cdo shkak.

Neni 29.

Dorheqia nga kontrata e ortakise, perjashtimi i ndonjerit nga ortaket prej shoqerise, behet ne perputhje me dispozitat e ligjit 7632 date 04.11.1992 "Per dispozitat e pjeses se Pergjitheshme te Kodit Tregtar" si dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare.

Konfliktet mes ortakeve zgjidhen ne rruge gjyqesore ne se ato nuk munde te zgjidhen me pajtim.

Neni 30.

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit te lartpermendur ne nenin 29 te ketije statuti si dhe cdo dispozite tjeter ligjore qe rregullon mardheniet ne fushen e shoqerive tregetare.

Neni 31.

Ky statut nenshkruhet nga ortaket e themelimit te kesaj shoqerie.

TOM DOSHI

TONIN SHPATI

PULLE TAKSE RESHQIPERISE PULLE TAKSE RESHQIPERISE PULLE TAKSE RESHQIPERISE PULLE TAKSE RESHQIPERISE PULLE TAKSE RESHQIPERISE

15029

# K E R K E S E

e

**KERKUESA.** Tom Gjek Doshi dhe Tonin Gjon Shpati me banim ne Shkoder Lagje Ndoc Mazi Rruga Kongresi Lushnjes Nr.77.

**OBJEKTI** Rregjistrimin si person juridik privat.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligji Nr.7667 date 28.01.1993

d r e j t u a r

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Te veprohet ... 30.05.1996 ...

Ne kerkuesit Tom Gjek Doshi dhe Tonin Gjon Shpati jemi themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ALDOSCH sh.p.k me seli ne qytetin Shkoder ne lagjen Ndoc Mazi Rruga Kongresi Lushnjes Nr.77, me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit si dhe te prodhimit te materjaleve per ndertim e tregetimin e tyre. Per kete qellim kemi perpiluar statutin, aktin e themelimit, kontraten e punes me ingjinjerin e ndertimi te paisur me licence perkatese si dhe te gjith dokumentacionin e nevojeshem per kete qellim.

Administrator dhe president i shoqerise eshte Tom Doshi. Per sa siper, paraqesim prane asaje gjykate dokumentacionin perkates per miratimin e kesaje shoqerie dhe rregjistrimin e saje si person juridik privat.

K E R K U E S I T

TOM DOSHI

96

TONIN SHPATI

*MINISTRIA E NDERTIMIT DHE TURIZMIT* *Z.0178*

*KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE*

# L I C E N S E

Z. Mimoza Iljaz Barbullushi, lindur me 29.10.1960, ne Shkoder, me profesion inxhinier ndertimi, diplomuar ne vitin 1980, ne Fakultetin e Inxhinierise, dega ndertim, banues ne Shkoder, lagja "Qemal Stafa",rruga "Vasil Shanto", pall.1

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese i jepet license per zbatim dhe regjistrohet ne regjistrin themeltar te zbatimit qe nga data 26.05.1995, per kategorite e specifikuara te punimeve :

Kat1 - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh.

Kat3/a - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

b - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat10/a - rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.

Sekretare e komisionit — Kryetar i Komisionit

Sllavena Safa — Andrea Mazniku

Pulla e Takses 1221

data 27-6.95

Shenim : Kjo licence eshte e vlefshme deri ne daten 26.05.2000.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE-SHKODER
VERTETOHET NJESIA ME ORIGJINALIN
NOTERE
ELVIRA BAKIAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E AVOKATISE TIRANE

Tirane,me 12.01.1998

15029 30/06/1996 4030

NR dep 12/06/97

KERKESE PER DEPOZITIM

**KERKUESI** : SHPK " ALDOSCH " perf.prej administratorit Tom Doshit

**OBJEKTI** : Te depozitohet kerkesa .Ne baze te ligjit 7667 dt. 28.1.1993 dhe ligjit 7638 dt.19.11.1992 .

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Me vendimin nr. 15029 dt. 30.06.1996 te gjykates se rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shpk"ALDOSCH " me ortaket themelues TOM DOSHI dhe TONIN SHPATI .

Me vendimin e asamblese se ortakeve dt.12.01.98 kemi vendosur shtimin e objektit te aktivitetit te shpk duke e ushtruar ate dhe ne fushen e eksport -import , me shumice e pakice, te mallrave artikujve ushqimore te gatshem drithrave ,pije alkolike , automjete e pjese kembimi per to dhe kozmetike .

Lutemi te depozitohen dokumentet .

Kerkuesi
(shpk"ALDOSCH "
perf.prej administratorit
TOM DOSHIT .

PULLE TAKSE 20 LEKE R.SHQIPERISE

Republika Shqiperise
Dhoma e noterise Tirane
nr; 494 rep.

Vertetim

Sot, me 12.01.1998 ne zyren e noterise Tirane u paraqit personalisht shpk" ALDOSCH" perf.prej Tom Doshit,me nr.pasaporte 0089363 ,madhor, me zotesi te plote

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot, me 12.01.1998 ( nentedhjete e tete )ne ortaket themelues te shpk"ALDOSCH " TOM DOSHI dhe TONIN SHPATI , ne mbledhjen e saj mora ne shqyrtim :

Shtimin e objektit te aktivitetit te shpk .

Pasi analizoi te gjitha kushtet ne te cilat vazhdon aktivitetin e saj shoqeria me vote unanime shpk"ALDOSCH " vendosi ;

Shtimin e objektit t e aktivitetit te shoqerise duke e ushtruar ate dhe ne fushen e eksport-import mallrash shumice e pakice te artikujve ushqimore te gateshme , drithra pije alkolike , automjete pjese ndrimi per to , kozmetike

O R T A K E T

( TOM DOSHI ) ( TONIN SHPATI )

Tom Doshi

Republika e Shqiperise
Dhoma e noterise Tirane
nr; 4P5 rep Tirane ,me 12.1.1998

v e r t e t i m

Vertetohet se Z. TOM DOSHI i dt.1966 ,lindur ne Tr banues ne Shkoder ,lagja Ndoc Mazi ,rruga"Kongresi i Lushn es nr.77 dhe TONIN SHPATI, i biri Gjonit,me banim ne Shkoder, lagja Ndoc Mazi nr.67 , madhore, me zotesi te plote per te vepruar, nenshkruajne para meje noteres vendimin e mare prej tyre dhe une e vertetoj sipas ligjit,pasi sigurohem per ident e tyre me pasaportat .

NOTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE 20 LEKE

SH.P.K "A L D O S C H"

S H K O D E R

15029/2
6499

Shkoder me 26.04.1999

# K E R K E S E

e

**Kerkues:** Tom Doshi, administrator i Sh.P.K."Aldosch" me seli ne Shkoder.

objekti

Depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve Nr. 1 date 25.04.1999 te Sh.P.K."Aldosch"

baza ligjore

Ligji Nr.7638 dt,19.11.1992 "Per shoqerite treget dhe Nr.7667 dt. 21.01.1993 "Per regjistrin tregta

perpara

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Z.Gjqtar! Me vendimin Nr.15029 dt.30.06.1996 te asaje gj eshte rregjistruar si person juridik provat Sh.P.K. "Aldosch" m seli ne Shkoder me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati. Me vendimin Nr. 1 date 25.04.1999 te asamblese se ortakeve te kesaje shoq eshte vendosur shtimi i aktivitetit me objekt fushen e treget (eksport imort) te karburanteve e vajerave lubrifikante si dhe fushen e prodhimit e tregetimit te artikujve duhan cigare.

Per sa me siper, i paraqes asaje gjykate kete

## K E R K E S E

Depozitimin e vendimit Nr. 1 date 25.04.1999 te asamblese se ortakeve te SH.P.K.ALDOSCH per shtimin e aktivitetit te shoqerise ne fushen e tregetimit( eksport import) te karburanteve e vajrave lubrifikante, te prodhimit e tregetimit te artikujve duhan cigare duke urdheruar zyren e rregjistrit tregetar te beje veprimet e nevojeshme.

ADMINISTRATORI I "SH.P.K."ALDOSCH"

TOM DOSHI

SH P K imp exp
ALDOSCH
SHKODER ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE — Nr. 2103 Rep.

DHOMA E NOTEREVE TIRANE — Nr. — Kol.

## V E R T E T I M

Ne Tirane sot me daten 27.04.1999(nentedhjet e nente) ne Dhomen e notereve Tirane e perpara meje noteres u paraqite personalishte Tom Doshi, president i Shoqerise "Aldosch"SH.P.K. i cili nenshkroj kerkesen per shtim objekti te aktivitetit te shoqerise dhe une noterja e vertetoj ate konforme ligjit........

N O T E R E

LIRI GJOLIKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE — LIRI GJOLIKU — NOTERE TIRANE

15029/3

gj: Anila Cayo
26.01.2004

**KËRKESË**

**KËRKUES:** Z. Tom Doshi, i biri i Gjekës, i datëlindjes 1966, lindur në Trush dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Qemal Stafa", Nr 231, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.1027599

**OBJEKTI:** Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 19.01.2004, për shitjen e kuotave të shoqërisë në masën 50% të tyre.

**PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**TIRANË**

**Zoti Kryetar,**

Shoqëria Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 15029, datë 30.06.1996 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Me cilësinë e administratorit të shoqërisë, paraqesë këtë kërkesë për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë datë 19.01.2004. Me anë të këtij vendimi është diskutuar dhe vendosur shitja e kuotave të shoqërisë në masën 50% të tyre të zotëruara nga ortaku Z. Tonin Shpati. Kuotat do të blihen nga Z. Tom Doshi, i cili fiton dhe cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Kërkesa për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 19.01.2004 për shitjen e kuotave të shoqërisë është bazuar në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në dispozitat e Statutit të Shoqërisë.

**KËRKUES**

**Tom DOSHI**

1. vendimi i ortakëve dt 19.01.2004
2. kontrata dit blerje dt 24.01.2004

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 4121 **Rep.**
**Nr.** — **Kol.**

# VËRTETIM

Sot, më datë 22.01. 2004, para meje Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Tom Doshi, i biri i Gjekës, i datëlindjes 1966, lindur në Trush dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Qemal Stafa", Nr 231, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1027599, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

**NOTERI**
**Agim ROBO**

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANË

PULLË TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**SHOQËRIA TREGTARE**
**"ALDOSCH" SH.P.K.**

# VENDIM
# I
# ASAMBLESË SË ORTAKËVE

Sot, më datë 19.01.2004, në selinë e Shoqërisë Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., Tiranë, u zhvillua Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve të kësaj shoqërie, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës së bërë të njohur paraprakisht, si më poshtë vijon:

1. Shqyrtimi i propozimit, për shitjen e kuotave të zotëruara nga ortaku i shoqërisë Z. Tonin Shpati, në tërësinë e tyre prej 50%, dhe blerjen e tyre nga ortaku tjetër Z. Tom Doshi.
2. Të ndryshme.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve, në prezencë të ortakëve të saj Z. Tonin Shpati dhe Z. Tom Doshi, proçedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Sipas propozimit të paraqitur, ortaku i shoqërisë Z. Tonin Shpati, ka shprehur vullnetin e tij për të shitur kuotat që ai zotëron në shoqëri, përkatësisht masën prej 50. % të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë. Këto kuota i janë ofruar ortakut tjetër të shoqërisë Z. Tom Doshi, i cili pas blerjes së 50% të kuotave bëhet zotërues gjithsej i 100% të kuotave të Shoqërisë, duke fituar kështu dhe cilësinë e ortakut të vetëm. Blerësi pranon kryerjen e operacioni të shit-blerjes së kuotave si më sipër.

Ortakët janë dakort për sa është diskutuar në pikën e parë të rendit të ditës dhe unanimisht vendosin shitjen e kuotave të shoqërisë në masën 50% të zotëruar nga Z. Tonin Shpati, i cili nuk do të ketë në të ardhmen asnjë të drejtë mbi to. Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, kapitali themeltar i shoqërisë do të zotërohet në këtë mënyrë:

- Z. Tom Doshi zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Për sa më sipër, dhe në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", do të lidhet dhe kontrata përkatëse e shitblerjes së kuotave.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Ortakëve, pas një diskutimi të gjatë të rendit të ditës dhe në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shitjen e kuotave të shoqërisë "ALDOSCH" Sh.p.k. në masën 50% të tyre, të cilat do të shiten nga ortaku Z. Tonin Shpati. Kuotat do të blihen nga ortaku tjetër Z. Tom Doshi, i cili pas këtij operacioni bëhet zotërues i 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë dhe fiton cilësinë e ortakut të vetëm.

2. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë Z. Tom Doshi, me depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë.

**ORTAKËT**

**Tonin SHPATI**

**Tom DOSHI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 2 3 ________ **Rep.**
**Nr.** 45 ________ **Kol.**

**VËRTETIM**

Sot, më datë 22.01. 2004, para meje Agim Robo, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Z. Tonin Shpati, i biri i Gjonit, i datëlindjes 31.01.1965, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1116688 dhe Z. Tom Doshi, i biri i Gjekës, i datëlindjes 1966, lindur në Trush dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Qemal Stafa", Nr 231, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1027599, të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

**NOTERI**

**Agim ROBO**

Bleresi, Z. Tom Doshi, është plotësisht dakort që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 50% të kuotave të zotëruara nga shitësit në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k.

**MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku Z. Tonin Shpati, humbet pronësinë e tij në masën 50% të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërië "ALDOSCH" Sh.p.k. dhe cilësinë e ortakut të kësaj shoqërie, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shoqërisë. Ndërsa bleresi Z. Tom Doshi, bëhet pronarë i 50% të kuotave të shitura, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave dhe gjithsej zotëron në shoqëri 100% të kuotave, duke fituar kështu cilësinë e ortakut të vetëm.

Shoqëria Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., pas realizimit të këtij operacionit shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si ortakë të saj me pjesmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- Z. Tom Doshi zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

**ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE**

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë "ALDOSCH" Sh.p.k. do të jetë shuma prej 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Sipas këtij përcaktimi, Bleresi Z. Tom Doshi, paguan në favor të Shitësit Z. Tonin Shpati, shumën prej 100.000 (njëqindmijë) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrit Tregtar, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në praninë time.

**PALËT**

| | |
|---|---|
| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
| **Tonin SHPATI** | **Tom DOSHI** |

**NOTER**

**ROBO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 424 Rep.
Nr. 46 Kol.

# KONTRATË

## SHIT – BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 24/01/ 2004, para meje Agim Robo, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Shitësi dhe Blerësi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuotash me termat e mëposhtme:

**SHITËSIT:** Z. Tonin Shpati, i biri i Gjonit, i datëlindjes 31.01.1965, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1116688.

**BLERËSIT:** Z. Tom Doshi, i biri i Gjekës, i datëlindjes 1966, lindur në Trush dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Qemal Stafa", Nr 231, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1027599.

**OBJEKTI:** Shitja e kuotave të shoqërisë "ALDOSCH" Sh.p.k. në masën 50%, kuota këto që zotërohen nga ortaku Z. Tonin Shpati, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga ortaku tjetër Z. Tom Doshi, me cilësinë e blerësit.

**PËRMBAJTA E KONTRATËS**

Shoqëria Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k. është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendimin nr. 15029, datë 30.06.1996. Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 lekë.

Me vendimin e datës 19.01.2004 të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie është vendosur miratimi i shitjes së kuotave në masën 50% të tyre nga ana e ortakut të shoqërisë Tonin Shpati dhe blerja nga ana e ortakut Z. Tom Doshi.

Shitja e 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërië "ALDOSCH" Sh.p.k. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi kuotat që ortaku Tonin Shpati zotëron në këtë shoqëri, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e mësipërm të Asamblesë së Ortakëve.

Shitësi Z. Tonin Shpati, është plotësisht dakort të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 50% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë "ALDOSCH" Sh.p.k. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit Z. Tom Doshi.

**SHOQERIA TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"ALDOSCH"**

Shkoder me 25.04.I999

## VENDIM

Nr. / date 25.04.I999

*I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SH.P.K "ALDOSCH"*

Asambleja e ortakeve e Sh.P.K. Aldosch me seli ne Shkoder e regjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane me Nr.regj.15029 me kodin fiskal Nr.3.353.033 mbasi shqyrtoi aktivitetin e saje konstatoi se:

SH.P.K. "Aldosch me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati, me administrator Z.Tom Doshi deri tani ka rregjistruar si aktivitet veprimtarine e ndertimit, tregetimit te artikujve ushqimor e industrial, pije alkoolike imoprt eksport automjete e pjese kembimi.
Duke pare aktivitetin e shoqerise, asambleja e ortakeve e mbledhur sot me daten 25.04.I999

VENDOSI

I) Te zgjeroje aktivitetin e shoqerise edhe ne fushat e tregetimit (eksport import) te karburanteve e vajerave lubrifikante si dhe te prodhimit e tregetimit te artikujve duhan cigare.
2) Administratori i shoqerise Z.Tom Doshi ti paraqes gjykates kopetente kerrkesen per depozitimin e ketije vendimi ne rregjistrin tregetar .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

I) Tonin Shpati

2)Tom Doshi

SH P K imp exp
ALDOSCH
SHKODER ALBANIA

SH.P.K "ALDOSCH"

15029/3

# K E R K E S E

e

Kerkues: Administratori i Sh.P.K."Aldosch" Tom Doshi

objekti i kerkeses

Shtimin e aktivitetit tregetar edhe ne fushen e shtypshkrimeve

baza ligjore

Ligji Nr.7638 dt.19.11.1992 per shoqerite tregetare dhe Nr.7667 dt.21.01.1993 per rregjistrin tregetar

*PERPARA*

GJYKATES RRETHIT
TIRANE

Z.Gjyqtare! Me vendimin Nr. 15029 dt.30.06.1996 te gjykates rrethit Tirane eshte rregjistruar Sh.P.K. Aldosch me seli ne Shkoder me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati.Me vendim te asamblese se ortakeve Nr. date 24/01/2000 eshte vendosur shtimi i objektit te aktivitetit edhe ne fushen e shtypshkrimeve nepermjet montimit e venies ne funksionim te nje shtypshkroje ne qytetin e Tiranes. Per sa me siper i paraqes asaje gjykate
kete

KERKESE

Shtimin e aktivitetit tregetar ne fushen e shtypshkrimeve nepermjet montimin e venies ne funksionim te nje shtypshkronje ne qytetin e Tiranes duke bere shenimet perkatese ne rregjistrin tregetar me vije te kuqe.

ADMINISTRATORI I SH.P.K. "ALDOSCH"
TOM DOSHI

SH P K Imp Exp
ALDOSCH
SHKODER ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA NOTERISE**
**TIRANE** 02183

**VERTETIM NENSHKRIMI**

**Sot me daten 25.01.2000 u paraqiten prane meje ne zyren e noterise Tom Doshi e Tonin Shpati per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet personale dshe pasi pashe se kane zotesi te plote per te vepruar, vertetoj nenshkrimet e tyre.**

**NOTERE**

POSTE TAKSE
100 LEKE
SHQIPERISE

SHOQERIA TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"A L D O S C H"

Shkoder me 24/01/2000

# V E N D I M

Nr. 1 date 24.01.2000

*I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SH.P.K "ALDOSCH"*

Asambleja e ortakeve e Sh.P.K. Aldosch me seli ne Shkoder e regjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane me Nr.regj.15029 me kodin fiskal Nr.3.353.033 mbasi shqyrtoi aktivitetin e saje konstatoi se:

SH.P.K. "Aldosch me ortake Tom Doshi e Tonin Shpati, me administrator Z.Tom Doshi deri tani ka rregjistruar si aktivitet veprimtarine e ndertimit, tregetimit te artikujve ushqimor e industrial, pije alkoolike imoprt eksport automjete e pjese kembimi. Tregetim me shumice e pakice I karburanteve e vajrave lubrifikante.

Duke pare aktivitetin e shoqerise, asambleja e ortakeve e mbledhur sot me daten 24.01.2000

## V E N D O S I

I) Te zgjeroje aktivitetin e shoqerise edhe ne fushat shtypshkrimeve nepermjet montimit e venies ne funksionim te nje shtypshkronje ne qytetin e e Tiranes.

2) Administratori i shoqerise Z.Tom Doshi ti paraqes gjykates kopetente kerkesen per shtimin e ketije ketije aktiviteti ne rregjistrin tregetar .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

I) Tonin Shpati

2)Tom Doshi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTERISE
TIRANE Nr. 182 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 25.01.2000 u paraqiten prane meje ne zyren e noterise Tom Doshi e Tonin Shpati per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet personale dshe pasi pashe se kane zotesi te plote per te vepruar, vertetoj nenshkrimet e tyre.

NOTERE

Elida Gaka

